



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 503/13 Prot.

Tiranë, më 12/3 /2014

URDHER

Nr 08, datë 12/03/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "*SANTE PLUS GROUP*" (*Qendër estetike*) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 227 datë 07.11.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "*SANTE PLUS GROUP*" (*Qendër estetike*) Tiranë me objekt:

- *Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21);*
- *Informimi i subjekteve të të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale (neni 18);*
- *Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale/sensitive dhe ruajtja e konfidencialitetit (nenet 27 dhe 28).*

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "*SANTE PLUS GROUP*" (*Qendër estetike*) në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, është kontrollues privat, i cili ushtron aktivitetin e tij në fushën e kujdesit estetik (*trajttime për dobësim, trajtimi me lazer, trajttime për mirëmbajtjen e lëkurës dhe masazhe*). Kontrolluesi nëpërmjet "*Formularit të regjistrimit të Klientit*" mbledh dhe përpunon të dhëna personale si: *emri, mbiemri, gjinia, moshë, numri i telefonit, e-mail, gjatësia, pesha, të dhëna shëndetësore, si dhe informacione tjera për klientin.*

Kontrolluesi ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke zbatuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e kontrollit administrativ të datës 05.02.2014,



1. Kontrolluesi mban të dhënat personale të klientëve të mbledhura në *"formularët e regjistrimit të klientëve"* për një afat të pacaktuar, të dhënat mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.

Në këtë rast është shkelur neni 5 pika 1 shkronja (d) e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se, kontrolluesit mund t'i mbajnë të dhënat personale vetëm për atë kohë sa ata kanë nevojë për to, lidhur me qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur dhe përpunuar më tej. Kjo periudhë do të jetë në varësi të qëllimeve për të cilat këto të dhëna nevojiten dhe kur nuk ka një bazë ligjore ku specifikohet periudha e ruajtjes, këto të dhëna duhet të shkatërrohen me mbarimin e qëllimit për të cilat janë mbledhur. Kontrolluesit nuk duhet që, për të dhënat personale të mbledhura dhe përpunuara prej tyre të mendojnë se mund të mbahen pasi mund të duhen përsëri, por sapo të dhënat të mos jenë të nevojshme, kontrolluesit duhet ti shkatërrojnë, duke respektuar kështu të drejtat e subjekteve për sigurinë e të dhënave personale të tyre. Kontrolluesit duhet të zbatojnë kriteret e vendosura nga Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ku parashikon se: *"Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me veten e tij apo të saj"*.

2. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre.

Për subjektet që plotësojnë *"formularët e regjistrimit të klientëve"* nuk ka një informim të plotë dhe të qartë lidhur me qëllimin, masat e sigurisë që aplikohen nga kontrolluesi, mënyrën e përpunimit, mbledhjes, ruajtjes, shkatërrimit, të drejtës për akses, si dhe korrigjim të të dhënave personale të tyre.

Në faqen tuaj në internet nuk janë publikuar *"politikat e privatësisë"* (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në këtë rast është shkelur neni 18/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, si dhe pika 3 e kreut II, të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 *"Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë"*.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mblidhen nga subjektet e të dhënave personale të interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqeve në internet duhet të kryhet sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

3. Kontrolluesi nuk ka hartuar një rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.



Në këtë rast janë shkelur nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen detyrat e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryhen nga kontrolluesit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 107-109 të K. Pr. Administrative :

## URDHEROJ

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

- Të shkatërrohen të dhënat personale të klientëve që nuk e frekuentojnë më qendrën estetike dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe të pikës 3 të kreut II të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”

- Të behet informimi i subjekteve që plotësojnë “formularët e regjistrimit të klientëve” lidhur me qëllimin, masat e sigurisë që aplikohen nga kontrolluesi, mënyrën e përpunimit, mbledhjes, ruajtjes, shkatërrimit, të drejtës për akses, si dhe korrigjim të të dhënave personale të tyre.
- Në faqen tuaj në internet të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t’i gjeni në Opinionin “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat” publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al).

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijëni të këtij Urdhëri.

5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

